



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICIONIN

#### “Studiues/e Shkencor”

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit “**Ekipet Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Studiues Shkencor**”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projektin do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollorë në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollor e mesëm (nga klasa 10 – 12); në universitete.

#### **Detyrat e Studiuesit/es Shkencor**

Jemi në kërkim të një studiuesi/hulumtuesi shkencor, për t’ju bashkuar ekipit të projektit Ekipet Sportive 2022, i cili do të bashkëpunojë ngushtë me ekipin e mjekëve të përfshirë në projekt, për të hartuar protokolle të ndryshme, kryesisht të matjeve të nxënësve si dhe për të shërbyer si personi përgjegjës për të prodhuar studimin kryesor shkencor të projektit. Ky person do të drejtojë punën për analizimin e të dhënave të prodhuara nga projekti dhe prodhimin e një studimi që do të analizojë situatën në Shqipëri në nivel makro sipas kampionit të nxënësve që prek projekti.

#### **Kualifikimet dhe Eksperienca:**

- Të jetë shtetas Shqiptar;





## Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

### Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

- Të ketë të përfunduar studimet master në programet e shkencave sociale ose Universitetin e Sporteve, preferohet të ketë titullin Doktor i Shkencave;
- Të ketë përvojë të dëshmuar të paktën 10 vite në fushën e hulumtimeve/studimeve apo në ndonjë pozicion ekuivalent;
- Të ketë aftësi të larta të hulumtimit, të komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke përfshirë aftësi analitike dhe aftësi të mira të prezantimit;
- Të ketë njohuri dhe eksperiencë me kurrikulat sportive në Shqipëri dhe rajon, përfshirë edhe njohuri të menaxhimit sportiv;
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar;
- Njohuri të shumë të mira të programeve kompjuterike: Microsoft Office (apo programeve statistikore);
- Aftësi të mira organizative, entuziast/e, i/e gatshëm të marrë përsipër përgjegjësi dhe udhëheqësi, i/e pavarur dhe i/e gatshëm të punojë në ekip.

#### **Procedura e aplikimit**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al), me subjekt: **Aplikim për pozicionin Studiues/e Shkencor "Ekipet Sportive 2022"**.

